



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN**

Elbasan më ____, ____, 2025

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMINE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

PROÇES-VERBAL PËR HARTIMIN E KRITEREVE

OBJEKTI I PROKURIMIT: "Ndërtimi i këmbëve të urave dhe speronave të urës tip beli mbi përroin "Lugaj", në fshatin Labinot, në Njësinë Administrative Labinot Mal", me fond limit **8.926.449** (tetëmilion e nëntëqind e njëzet e gjashtë mijë e katërqind e dyzet e nëntë) **lekë pa t.v.sh.**

LLOJI PROÇEDURËS - "Procedurë e hapur e thjeshtuar -Punë"

- **KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Kodi CPV: 45210000-2 - Punime ndërtimi**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", autoriteti/enti kontraktor, Bashkia Elbasan, ka hartuar proces verbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme përvërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Kriteret e përgjithshme përmbajne listën e dokumentacionit, ligjor dhe administrativ, të kandidatëve/ofertuesve, që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, në përputhje me nenin 76 dhe 77 të LPP-së, nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”.

Kriteret e përgjithshme për pranimin e operatorëve pjesëmarrës janë të pandryshueshme dhe janë vënë të njëjta me Dokumentet Standarde të Tenderit të miratuara nga APP me Vendimin Nr. 08 Datë 23.09.2024.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Kriteri (1- a) është vendosur në bazë të nenit 83 të LPP dhe nenit 30 pika 1 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Kriteri (1-b) bazohet në nenet 76, 77 dhe 82 të LPP si dhe nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale: sipas shtojcës 7.

2.1.1 Operatori ekonomik duhet të ketë paguar **taksat dhe tarifave vendore për vitin 2025 (këstet e maturuara)**. Pagesa e taksave dhe tarifave vendore duhet të bëhet për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB), sipas afateve të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të ketë paguar taksat dhe tarifave vendore).

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 76, pika 2 të LPP si dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar që operatorët ekonomikë nuk kanë pagesa të pashlyera të taksave dhe tarifave vendore.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vendosija e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se vlera limit e kontratës që prokurohet.

-Për të vërtetuar përvojën e mëparshme duhet të paraqiten:

-Nëse kontrata është realizuar me institucione shtetërore: Formulari i vlerësimit (sipas shtojcës 9) i shoqëruar me: -Kontratë punimesh; -Situacion përfundimtar; -Akt-kolaudimi; -Procesverbal për marrje në dorëzim të punimeve të kryera.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e bashkimit të operatorëve ekonomikë si dhe preventivin e ndarjes së punimeve të marra përsipër nga secili operator ekonomik të deklaruar në fazën e tenderimit.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

-Nëse kontrata është realizuar me subjekte private: Formulari i vlerësimit i shoqëruar me: - Kontratë punimesh, -Situacionin përfundimtar, -Akt-kolaudimin, -Çertifikatën e marrjes në dorëzim, -Faturat tatimore të deklaruar në organet tatimore.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Investitorit.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura për përvojën e suksesshme e bën ofertën të kualifikueshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 39, pika 5 dhe nenit 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 30 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo me te vogël se vlera e fondit limit të objektit të prokurimit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Liçensa profesionale e shoqërise për realizimin e punimeve, objekt i kontratës:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI:

- **N.P - 1 A** Punime gërmimi në tokë
- **N.P - 5 A** Punime nëntokësore, ura e vepra arti

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI:

- **N.S - 18 A** Punime topogjeodezike

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit perkates , ne plotesimin te licensave profesionale te kerkuara per ekzekutimin e kontratës .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe ne Vendimin e Keshillit të Ministrave nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”, i ndryshuar me VKM nr 92 .DT 19.02.2014 ku jane te percaktuar kategorite perkatese dhe niveli i klasifikimit per licensat e subjekteve qe ushtrojn veprimtari ne fushen e ndertimit.

Kategoritë e licensave jane percaktuar ne baze te zerave te pershkruara ne preventivin e projektit.

Niveli i Shoqërisë sipas vlerave në lekë të punimeve të kryera për çdo kategori punimi.

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1	Punime gërmimi në tokë	Punime gërmim dheu sipas preventivit: Gërmim dheu themele e plinta me b>2m, ekskavator me goma 0.25m3,shkarkimi ne toke	A	0-20 milion
NP-5	Punime nëntokësore, ura e vepra arti	Punimet per ndertimin e ures sipas preventivit	A	0-20 milion

NS-18	Punime topogjeodezike	Punimet per kuotat dhe piketimin e objektit	A	0-20 milion
-------	-----------------------	---	---	-------------

2.3.3 Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administrator i shoqërisë), Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në listpagesat e shoqërisë, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm;

- a) Kontratë pune
- b) Diplomë

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues për drejtuesin teknik, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues për drejtuesin teknik, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

2.3.4 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të cilët duhet të figurojnë në licencën si dhe listëpagesat e shoqërisë për dy muajt e fundit, si mëposhtë:

- 1 (një) inxhinier Nderimi/Hidroteknik
- 1 (një) inxhinier topograf/geodet

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës noteriale e vlefshme dhe diploma.

Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar, sa i takon ndalimeve të dypunësimit. **Per kete arsye te paraqitet deklarate perkatese nga Administratori i shoqërisë.**

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues që OE i disponon punonjësit e mësipërm do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të

Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe ne Vendimin e Keshillit të Ministrave nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar me VKM nr. 92, datë 19.02.2014 ku janë të percaktuar kategoritë perkatese për licensat e subjekteve që ushtrojnë veprimtari në fushën e ndërtimit. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Punimet apo veprimtaritë konkrete, të cilat lidhen edhe me kategoritë e licenses, për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale:

1 (nje) Inxhinier Ndërtimi/Hidroteknik	Eshtë përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar preventivit të punimeve
1 (nje) Inxhinier Gjeodet	Eshtë përgjegjës për zbatimin e saktë të kuotave të projektit <i>punime që përfshihen në kategorinë NS-18</i>

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik, punonjës të kualifikuar dhe të thjeshtë, si mëposhtë:

- 1 (nje) punonjës teknik ndërtimi
 - 1 (një) punonjës teknik topograf
 - 4 (kater) karpentiere
 - 2 (dy) hekurkthyes
 - 2 (dy) betonues
 - 2 (dy) shofere
 - 1 (nje) manovrator eskavatorist
 - 1 (nje) manovrator buldozerist
 - 2 (dy) manovratore automakiniste
 - 8 (tete) punonjës të thjeshtë/ndihmes
- Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për dy muajt e fundit.
 - Për inxhinierin të paraqitet diploma perkatese e lëshuar nga Institucione Arsimore të Arsimit të Lartë të akredituara.
 - Për punonjësit e kualifikuar të ndërtimit të paraqitet Çertifikatat/diplomat/deshmia të lëshuara nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.SH” i ndryshuar.
 - Për teknikun e ndërtimit dhe teknikun topograf do të pranohet vetëm diploma e shkollës së mesme/licence profesionale nga institucionet përkatëse.

- ***Nuk do të njihen si dëshmi profesionale kurset e trajnimit të lëshuara nga subjektet të cilat nuk janë të licensuara/akredituara nga institucionet përkatëse për licensimin/akreditimin e tyre.***
- Ndersa per punonjesit shofere dhe manovratorë të mjeteve të rënda duhet të paraqiten dëshmi te aftesise profesionale / leje drejtimi dhe certificate e aftesimit profesional sipas rastit, të lëshuara nga D.P.SH.T Rrugore.
- **Në rast se operatori ekonomik, i disponon mjetet në pronësi, duhet ti ketë drejtuesit e mjeteve (shoferet dhe manovratorët) në listëpagesë për dy muajt e fundit.**
- **Për mjetet, të cilat janë të marra me qira, OE duhet të paraqesë për drejtuesit e mjeteve (shoferet dhe manovratorët), kontratën e punës së vlefshme, dëshmi te aftesise profesionale / leje drejtimi dhe certificate e aftesimit profesional sipas rastit, të lëshuara nga D.P.SH.T Rrugore, por pa qenë e nevojshme që këta të figurojnë në listëpagesën e OE.**

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues qe OE i disponon punonjesit e mesiperm do të dorëzohet nga **ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.**

Argumentimi: vendosja e ketij kriteri bazohet në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për punonjesit e kualifikuar lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve, duke krijuar besueshmërinë se kane përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Në përcaktimin e profileve konkrete te stafit teknik punonjesve te kualifikuar, si dhe numrit te tyre, AK eshte bazuar ne manualin e çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, date 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit te integruar per informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”, VKM nr. 514, date 20.09.2017 “Per miratimin e listes kombetare te profesioneve (LKP), te rishikuar, Urdherin nr.200, date 16.05.2019 te Ministrit te Infrastruktures dhe Energjitikes “Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit“, Ligjin Nr. 7961, datë 12.7.1995 “KODI I PUNËS I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË“, i ndryshuar, zerat e punimeve te preventivit, volumet per keto zera dhe të grafikut të punimeve.

- **Tekniku i ndërtimit** është i nevojshem për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit, sipas zërave të preventivit të punimeve, sic jane gërmimet, punimet e shtresave, punimet e betonit, etj, lexon dhe kontrollon zbatimin e projektit ne perputhje me kushtet teknike te zbatimit (KTZ), implementon kërkesat dhe direktivat e inxhinierit dhe ndan detyrat per punetoret dhe ndjek ecurine e tyre gjate kohes se punes.
- **Tekniku topograf** është i nevojshem për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit, për zbatimin e saktë të kuotave të projektit ne punimet qe do te kryhen duke asistuar drejtuesin teknik.
- **Karpentierët** janë të nevojshëm për punimet beton arme, punime themeli, kollona e soleta sipas zerave te preventivit. Bejne piketimin dhe armaturen anesore te themelit, bejne vendosjen e modinave per kolonat dhe muret e betonit, ndertojne armaturen, kallepet e kolonave, mureve,

montojne skelerine perforcuese per fazen e betonimit te mureve dhe kolonave, prerjen dhe montimin e strukturave prej druri e metali si dhe ndertimin e kornizave dhe strukturave te tjera perforcuese prej druri, bashkimin dhe montimin e elementeve metalik apo materiale te tjera, te nevojshme per realizimin e objektit qe do te ndertohej. Numri i kerkuar eshte bazuar te grafiku i punimeve, ku te gjitha punimet ku kerkohet prezenca e punonjesve karpentiere eshte parashikuar te realizohet ne muajin e dyte dhe te trete, si dhe tek perlllogaritjet e bera bazuar ne manualin e çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, date 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit te integruar per informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” per kohen e punes qe duhet per te realizuar cdo ze te punimeve te parashikuara ne preventiv.

- **Hekurkthyesi** është i nevojshem për përzgjedhjen, prerjen, kthimin dhe vendosjen e hekurit, për realizimin zërave të punimeve te hekur betonit sipas preventivit. Numri i kerkuar eshte bazuar te grafiku i punimeve, ku punimet e hekur betonit jane parashikuar te realizohen ne muajin e dyte, si dhe tek perlllogaritjet e bera bazuar ne manualin e çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, date 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit te integruar per informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” per kohen e punes qe duhet per te realizuar cdo ze te punimeve te parashikuara ne preventiv.
- **Betonuesi** është i nevojshëm për realizimin e punimeve te betonit sipas zerave te preventivit. Ndhmon në ndërtimin e armaturës brenda së cilës do derdhet betoni, vendosin shtyllat mbajtëse të peshës, morsetat dhe mjetet e tjera që sigurojnë qëndrueshmërinë e armaturës ndaj peshës dhe presionit të ngarkesës beton, Shpërndajnë betonin dhe e shtrojnë atë në soleta, kolona, shkallë, mure, ballkone, ura, apo strukturave të tjera në kohën e duhur, sipas radhës së përcaktuar nga projekti dhe drejtuesi teknik i objektit, bëjnë vibrimin e betonit gjatë çdo betonimi, kryejnë nivelimin e betonit, kryejnë lustrimin e betonit apo çimentos. Numri i kerkuar eshte bazuar te grafiku i punimeve, ku te gjitha punimet ku kerkohet prezenca e punonjesve betonues eshte parashikuar te realizohet ne muajin e dyte, si dhe tek perlllogaritjet e bera bazuar ne manualin e çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, date 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit te integruar per informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” per kohen e punes qe duhet per te realizuar cdo ze te punimeve te parashikuara ne preventiv.
- **Shoferi** eshte i nevojshem për drejtimin e mjeteve si kamion. Numri i kerkuar eshte bazuar ne numrin e mjeteve qe duhen per transportin e materialeve qe do te perdoren per realizimin e objektit.
- **Manovratori eskavatorist** eshte i nevojshem per përdorimin e makinerive të renda te ndertimit si eskavator germimi, fadrome, te cilat jane kerkuar pasi ne preventiv jane parashikuar punime qe kerkojne perdorimin e ketyre makinerive. Ne nenin 8, germa a, të rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës percaktohet: Makineritë e rënda të ndërtimit dhe emërtimet bëhen sipas Dëshmimeve të Aftësive Profesionale (DAP), të cilat ndahen si më poshtë:

a)-eskavator germimi e ngarkimi dherash të të gjitha llojeve si dhe fadromat e të gjitha llojeve (me goma dhe me zinxhirë), manovratorëve u jepet dëshmi për **ESKAVATORIST**.

- **Manovratori buldozerist** është i nevojshëm për përdorimin e makinerive të rënda të ndërtimit si **grejder**, i cili është kërkuar pasi në preventiv janë parashikuar punime që kërkojnë përdorimin e kësaj makinerie. Në nenin 8, germa b, të rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës përcaktohet: Makineritë e rënda të ndërtimit dhe emërtimet bëhen sipas Dëshmive të Aftësive Profesionale (DAP), të cilat ndahen si më poshtë:

b)- buldozer gërmimi, shtyrje, nivelimi e ngjeshje dherash apo shpim toke: të gjithë llojet e traktorëve me thikë (ruspë), ose që tërheqin skreper, grejder apo nivelues, rul vibrues, shtruese asfalto-betoni, skreperët, **grejderët** dhe niveluesit kur janë vetëlëvizës, të gjithë llojet e traktorëve, me pajisje shtesë për ngritjen e peshave, shpimin e puseve etj. **manovratorëve u jepet dëshmi për BULDOZERIST.**

- **Manovratori automakinist** është i nevojshëm për përdorimin e makinerive të rënda të ndërtimit si **autobetoniere, autopompa betoni, autovinca**, të cilat janë kërkuar pasi në preventiv janë parashikuar punime që kërkojnë përdorimin e këtyre makinerive. Në nenin 8, germa c, të rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës përcaktohet: Makineritë e rënda të ndërtimit dhe emërtimet bëhen sipas Dëshmive të Aftësive Profesionale (DAP), të cilat ndahen si më poshtë:

c)-Automjete për përdorim të veçantë (APV) sipas pikës “g”, të nenit 54, të Kodit Rrugor, makineri ndërtimi mbi bazë automjeti:-autovinça, autobetonierë, autopompa betoni, autobitumatriçe, autosonda, autotokmak, manovratorëve u jepet dëshmi për **AUTOMAKINIST.**

2.3.6 Një punësim mesatar për dy muajt e fundit, i të paktën **26** (nëzet e gjashtë) personave të vërtetuar me:

- a) Vërtetim të lëshuar nga autoritetet përkatëse, në mënyrë elektronike, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;
- b) Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar.

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues që OE i disponon punonjesit e mesipërdo të dorëzohet nga **ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.**

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Autoriteti kontraktor në përcaktimin fuqisë punëtore të nevojshme për realizimin e kontratës është bazuar në llogaritjen e orëve të punës sipas manualit të çmimeve të ndërtimit

miratuar me VKM Nr.216, date 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”, Ligjin Nr. 7961, datë 12.7.1995 “KODI I PUNËS I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË“, i ndryshuar, grafikun e punime, zërat e punimeve të preventivit, volumet për keto zëra. **Duke e bazuar në keto komponente AK percaktoi stafin kryesor teknik (inxhinieret), një numër minimal punonjesh të kualifikuar për çdo lloj punimesh dhe një numër minimal punonjesh të thejshte/ndihmes. Nga ky numër rezultoi se për të perfunduar brenda afatit dhe me sukses zbatimin e kontratës operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë minimalisht një numër prej 26 punonjesh (stafi kryesor teknik + punonjes të kualifikuar + punonjes të thejshte/ndihmes).**

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij punonjes të certifikuar si më poshtë:

- 1 (një) punonjes i pajisur me çertifikate “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, (I ndryshuar).

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për dy muajt e fundit.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues që OE i disponon punonjësit e mësipërm do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimit.

Argumentimi: Këto kritere janë vendosur për të bërë në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të Ligjit 10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” si dhe të VKM Nr.312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, ligjit nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, neni 49, pika 4. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Njësia e prokurimit gjykon se për mbarrëvajtjen e punimeve, me qëllim garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen e shëndetit, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident si dhe në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni sektorial në fuqi, është e nevojshme prezencë e ekspertit për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në kantierin e punimeve si dhe punonjësve të kualifikuar për punimet në lartësi. Në nenin 6 të ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë, i ndryshuar parashikohet:

”Detyrime të përgjithshme të punëdhënësve

1. Punëdhënësi, për sigurimin e mbrojtjes së punëmarrësve në të gjitha aspektet, që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë, merr masat e nevojshme nëpërmjet:

- a) parandalimit të rreziqeve për aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale;
- b) informimit dhe formimit profesional të punëmarrësve e të përfaqësuesve të tyre;
- c) organizimit të mbrojtjes kolektive dhe individuale;
- ç) sigurimit të organizimit të vendit të punës e të mjeteve të nevojshme.

2. Punëdhënësi kujdeset për përditësimin e masave të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duke marrë parasysh ndryshimet e rrethanave, për përmirësimin e situatave ekzistuese.

Në nenin 7 Shërbimet e mbrojtjes dhe të parandalimit, parashikohet:

1. Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarrës, që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë dhe të parandalimit të rreziqeve profesionale në ndërmarrje/institucion.

2.3.8 Operatori Ekonomik duhet te disponoje dhe paraqese certifikata te vlefshme:

- SSH/EN-ISO 9001 (*Sistemi i menaxhimit të cilësisë*) ose ekuivalent
- SSH/EN-ISO 14001 (*Sistemi i menaxhimit të mjedisit*) ose ekuivalent

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, cdo anëtar i këtij bashkimi duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes).

Argumentimi: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sa më sipër janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 dhe 2 ku citohet se: 1. “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”; 2. Autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon:

a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara;

b) efikasitetit të energjisë;

c) sistemeve të menaxhimit mjedisor,

si dhe ne zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 45001 është standard ndërkombëtar, i cili parashtrohet kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion, të cilat janë si më poshtë vijon:

Nr	Lloji i makinerive/pajisjeve/mjeteve	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Eskavator me goma me kove +çekiç	Pronësi/Qira	copë	1
2	Automjet vetshkarkues me kapacitet mbajtes min 8 ton	Pronësi/Qira	copë	2
3	Kamion vinc	Pronësi/Qira	copë	1
4	Autobetoniere	Pronësi/Qira	copë	2
5	Autopompe betoni	Pronësi/Qira	copë	1
6	Grejder	Pronësi/Qira	copë	1
7	Vibrator thelesie	Pronësi/Qira	copë	2
8	Tranxh Hekuri	Pronësi/Qira	copë	1

a) Për mjetet që regjistrohen ne regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si dhe çertifikatë për transport mallrash (vetem mjetet e transportit). Në rastin e mjeteve apo pajisjeve te tjera duhet te paraqiten aktet e çdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.

Per mjetet e siguruara me qira, dokumentet e mesiperme duhet te shoqerohen me kontraten noteriale perkatese te qirase, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi.

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues, që OE i disponon mjetet e mësipërme, do të dorëzohet nga operatori **ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç, 6/d dhe 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Gjithashtu kriteri është vendosur referuar zerave te punimeve.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar ne VKM Nr.216, date 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit te integruar per informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”.

Në mbështetje të dispozitës ligjore të sipërcituar Ligjvënësi i jep të drejtën Autoritetit Kontraktor të kërkojë nga ana e operatorëve ekonomike **makinerite, mjetet dhe paisjet teknike**. Njësia e Prokurimit ka vlerësuar si të domosdoshëm paraqitjen e deklaratave dhe dokumentacionit përkatëse ne lidhje me mjetet dhe paisjet teknike që Operatori ekonomik disponon në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi.

Percaktimi i makinerive është bere referuar zerave të punimeve reflektuar ne tabelë sa më poshtë:

Nr	Lloji i Makinerive	Proceset sipas preventivit	Sasia
----	--------------------	----------------------------	-------

1	Eskavator me goma me kove + çekiq	Punimet sipas preventivit: Germim themel vecuar (gropa) sip.10-30 m2, shkemb i bute me h=2.5 m, me makineri, e zakonshme (shpatulla djathtas); Germim dheu themele e plinta me b>2m, ekskavator me goma 0.25m3, shkarkimi ne toke	copë 1
2	Kamion veteshkarkues min 8 ton	Per transportin e materialeve ne kantier si hekur, zhavor, çakell. Transport dheu me auto deri 1 km;	cope 2
3	Kamion me vinç	Per punimet sipas preventivit, te cilat kerkojne perdorimin e ketij mjete: F V hekur betoni periodik, Ø 6 - 10mm; F V hekur betoni periodik Ø > 12mm	copë 1
4	Grejder	Per punimet sipas preventivit: Mbushje me cakell pas mureve	copë 1
5	Autobetoniere	Per transport betoni per punimet sipas preventivit: Pllake themeli, trare e bazamente b/a C 20/25; Themel betoni C 16/20; Mur betoni C 16/20; Struktura monolite betoni C 20/30, shtrese betoni C 16/20	copë 2
6	Autopompe betoni	Hedhja e betonit sipas proceseve te punes te parashikuara ne preventiv	copë 1
7	Tranxhe për perpunimin e hekurit	Per prerjen dhe kthimin e hekurit sipas zerave te preventivit: F V hekur betoni periodik, Ø 6 - 10mm; F V hekur betoni periodik Ø > 12mm.	copë 1
8	Vibrator thellesie	Per punimet e betonit sipas preventivit: Pllake themeli, trare e bazamente b/a C 20/25; Themel betoni C16/20; Mur betoni C 16/20; Struktura monolite betoni C 20/25, Struktura monolite betoni C 16/20, Struktura monolite betoni C 25/30 .	copë 2

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet Teknike per proceduren respektive jane hartuar nga drejtoria e projekteve, pjese perberese e struktures se Bashkise Elbasan, qe ka hartuar edhe projektin perkates te zbatimit duke qene elemente perberes te tij. Ne hartimin e tyre jane marre ne konsiderat kerkesat ligjore te fushes se planifikimit dhe zhvillimit te territorit si dhe normat perkatese te Ligjit nr. 9290 , date 7.10.2004 “Për produktet e ndërtimit” i ndryshuar dhe Vendim i KM nr.312, datë 5.5.2010 Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” si dhe kerkesat e ligjit te Ligjit Nr. 10480 datë 17.11.2011 , "Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore".

Specifikimet Teknike jane pjese e setit te dokumentave te ngarkuara ne SPE per proceduren respektive.

Fondi Limit i perlogaritur per kete procedure eshte hartuar ne baze te VKM Nr.216, date 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit te integruar per informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”,

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke**

argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.